Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Financije, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labor end Transfers
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Anketa e Fuqisë Punëtore

TM4 2020



ask
AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Parathënie

Qëllimi i Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) në Kosovë është të ofrojë të dhëna statistikore mbi indikatorët statistikorë të tregut të punës dhe të mundësojë krahasimin e tyre me vitet dhe tremujoret paraprake. Anketa e Fuqisë Punëtore përfshin 450 Qarqe Regjistruese (QR) në tërë territorin e Kosovës.

Raporti mbi AFP-në, në tremujorin e katërt të vitit 2020 përmban të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, gjendjen e punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe fushave të tjera të tregut të punës.
Në tremujorin e katërt të 2020, shkalla e punësimit është 30.2 %, shkalla e papunësisë është 27.0 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit është 58.7 %.
Të dhënat e AFP-së tregojnë që përqindja e personave të punësuar me orar të pjesshëm për tremujorin e katërt të këtij tremujori është 8.0 %. Vetëpunësimi (si përqindje e të punësuarve) për këtë tremujor është 21.4 %. Përqindja e të punësuarve në punë të paqëndrueshme (personat, që janë të vetëpunësuar dhe nuk kanë punonjës dhe ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar) ishte 16.0 %. Tregtia, ndërtimtaria, prodhimi dhe arsimi vazhdojnë të punësojnë më shumë se gjysmën e personave të punësuar.

Sa i përket pjesëmarrjes në fuqinë punëtore që është 41.3 % në këtë periudhë, numri i femrave që i përkasin fuqisë punëtore ishte 23.8 % ndërsa meshkuj ishte 59.1 %.
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 49.9 %.
Papunësia afatgjate e të rinjve (15-19), që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj për këtë tremujor është 51.8 %.
Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim – NEET (të intervistuarit e moshës 15-24 vjeç), është 31.5 %.

Me këtë rast, ASK-ja falënderon pjesëmarrësit dhe akterët e tjerë, e posaçërisht stafin e vetë në realizimin e tremujorit të katërt të AFP-së 2020. Njëkohësisht, i bën me dije të gjithë përdoruesit e statistikave zyrtare se ASK-ja, brenda mundësive buxhetore, në vazhdimësi po bën përpjekje për ngritjen e kapaciteteve për të publikuar statistika të qëndrueshme dhe sa më cilësore.

Në bazë të Ligjit të Statistikave Zyrtare Nr.04/L-034, Agjencia e Statistikave të Kosovës është përgjegjëse për prodhimin e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës, prandaj, gjatë shfrytëzimit të këtyre të dhënave, duhet të citohet burimi.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-gov.net

Avni Kastrati - Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
Naime Rexhepi - Shefe e Divizionit të Statistikave Sociale

Publikimin e përgatitën:

Bujar Hajrizi - Shef i Sektorit
Bedrije Demaj - Zyrtare e lartë
Besarta Thaçi - Zyrtare

Qershor, 2021

Z.V. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së
Ilir.T.Berisha

Hyrje

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ka filluar realizimin e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) në vitin 2001, duke vazhduar si anketë vjetore deri në vitin 2009. Për shkak të përgatitjes së regjistrimit të popullsisë, Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) nuk u realizua në vitin 2010 dhe 2011.

Nga viti 2012 Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) zhvillohet sipas metodologjisë së Eurostatit si anketë e vazhdueshme (52 javë kalendarike - javë referuese), si dhe:

- Pyetësori i përmirësuar (duke vazhduar me respektimin e udhëzuesve të Eurostat-it)

- Korniza e re e mostrës (bazuar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe banesave të vitit 2011 në Kosovë)

- Rrotacioni i mostrës do të thotë se proporcioni i mostrës zëvendësohet në çdo raund të anketimit sipas një modeli të rrotullimit të paracaktuar. Mostra përbëhet nga një numër i nën-mostrave ose grupe me rrotacion. Çdo raund studimi, një grup i ri rotacioni futet në mostër për të zëvendësuar grupin e rotacionit nga raundi i mëparshëm i anketës. Pjesa e mostrës që është e zakonshme për dy raundet e studimit lejon vlerësimin e ndryshimeve bruto dhe mundëson vlerësime të besueshme të ndryshimeve neto. Gjithashtu, nga një këndvështrim praktik, lejohet intervistimi i pavarur dhe kontrollet e përmirësuara gjatë analizës së të dhënave

- Intervistimi i ekonomive familjare është realizuar me anë të laptopit, përkatësisht përmes metodës CAPI – Intervista Personale me Asistencë Kompjuterike, e cila mundëson gjenerimin e të dhënave më shpejt se sa përmes metodës PAPI, përkatësisht metodës së intervistimit tradicional të mbledhjes së të dhënave me letër dhe laps, të cilat futen më pas në kompjuter.

Objektivat kryesore të AFP-së janë grumbullimi i informatave kryesisht për anën e ofertës së tregut të punës, d.m.th. informatave mbi ata që punojnë apo që janë aktivë në kërkim të një pune.

.

Falënderim

Nga viti 2014, AFP-ja realizohet me buxhetin e ASK-së. Shprehim mirënjohjen tonë ndaj punës të zyrave rajonale të ASK-së, të cilët kanë mbikëqyrur punën në terren, dhe ndaj familjeve, që kanë ndarë kohën e tyre dhe kanë ofruar të dhëna duke ndihmuar në këtë mënyrë mbledhjen e këtyre informacioneve të detajuara.

Shkurtesat

AFP - Anketa e Fuqisë Punëtore

ONP - Organizata Ndërkombëtare e Punës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

NACE - Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike

ISCO - Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve

QR - Qark Regjistrues

NEET - Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim

Përmbajtja

Faqe
Parathënie 1
Hyrje 2
Falënderim 3
Definicione 7
Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në të dhënat e tregut të punës në Kosovë në TM4 2020 10
Tab. A: Javët referuese për tremujorin e katërtë 11
Tab. B: Qarqet regjistruese, ekonomitë familjare dhe persona të intervistuar në tremujorin e katërtë 11
Treguesit kryesorë 12
Tab. 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës 14
1. Punësimi 15
1.1: Punësimi sipas gjinisë 15
1.2: Punësimi sipas grup moshës dhe nivelit arsimor 15
Tab.1.1: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës 16
Tab. 1.2: Punësimi sipas nivelit arsimor 16
Tab. 1.3: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhënësit (15-64) 17
1.3: Statusi i punësimit 17
Tab. 1.4: Statusi i punësimit sipas gjinisë (%) 17
1.4: Punësimi i paqëndrueshëm 17
Tab. 1.5: Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë 18
Tab. 1.6: Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë 18
Tab. 1.7: Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë 19
1.5: Llojet e kontratave 19
1.6: Punësimi sipas aktiviteteve 20
Tab. 1.8: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në mijëra) 20
Tab. 1.9: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në %) 21
1.7: Punësimi sipas profesioneve 22
Tab. 1.10: Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë (në %) 22
1.8: Modelet e punës 23
Tab. 1.11: Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm sipas gjinisë (%) 23
Tab. 1.12: Punësimi sipas orëve të punës në javë dhe sipas gjinisë 24
Tab. 1.13: Numri mesatar i orëve të punuara në jave sipas llojit të punëdhënësit dhe 24
Tab. 1.14: Modelet e punësimit sipas gjinisë 25
1.9: Paga mujore neto 26
2. Papunësia 27
2.1: Papunësia sipas gjinisë 27
Tab. 2.1: Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë 27
2.2: Papunësia sipas grup moshës dhe nivelit arsimor 28
Tab. 2.2. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës 28
Tabela 2.3. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe 28
2.3: Papunësia tek të rinjtë 29
Tab. 2.4: Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme dhe shkalla e 29
Tab. 2.5: Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj të rriturve, sipas gjinisë 29
2.4: Kohëzgjatja e papunësisë 30
Tabela 2.6: Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe 30
Graf. 2.2. Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe 30
3. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 31
Graf. 3.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë 31
Tab. 3.1: Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë 32

4. Personat joaktivë 33
Graf 4.1: Shkalla e pjesëmarrjes jo aktive sipas gjinisë 33
4.1: Të rinjtë joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin 34
Tab. 4.1: Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollë ose trajnim (NEET) 34
5. Shkallët e varësisë demografike dhe ekonomike 35
Tab. 5.1: Shkallët e varësisë demografike 35
Tab. 5.2: Shkallët e varësisë ekonomike 35
6. Saktësia e të dhënave 36
Tab. 6: Saktësia e vlerësimeve në bazë të AFP-së për tremujorin e katërtë të vitit 2020 36
7. Indikatorët kryesor në shtetet e Evropës Juglindore 37
Tab. 7.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 37
Tab. 7.2: Shkalla e punësimit 37
Tab. 7.3: Shkalla e papunësisë 37
Tab. 7.4: Shkalla e jo aktivitetit 37

Definicione

Popullsia në moshë pune përfshin personat e moshës 15 deri 64 vjeçare. Kjo masë përdoret për të dhënë një vlerësim të numrit të përgjithshëm të punonjësve potencialë brenda një ekonomie.

Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, sipas përkufizimeve të sakta, të paraqitura mëposhtëm. Personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore.

1. **Të punësuar:** personat, të cilët gjatë javës referente kanë bërë ndonjë punë për pagesë, fitim ose përfitim familjar, në të holla ose në natyrë, ose ata që mungonin përkohësisht në punën e tyre.

2. **Të papunë:** personat, të cilët gjatë javës referente:

- Ishin pa punë, d.m.th. nuk ishin të punësuar me pagesë ose të vetëpunësuar;

- Aktualisht ishin të gatshëm për punë, d.m.th. ishin të gatshëm të fillojnë punë me pagesë ose vetëpunësim brenda dy javësh; dhe

- Kërkonin punë, d.m.th. kishin ndërmarrë hapa specifikë gjatë katër javëve të fundit në kërkim të punësimit me pagesë ose vetëpunësimit.

3. **Persona joaktivë:** personat, të cilët gjatë periudhës referente nuk ishin as të punësuar as të papunë.

Klasifikimi i popullsisë në këto tri kategori të lartpërmendura varet nga aplikimi i parimit të aktivitetit – çfarë ka bërë personi në të vërtetë gjatë javës referuese - dhe një grup rregullash prioritare mbi aktivitetin, që i japin përparësi punësimit mbi papunësinë dhe papunësisë mbi jo aktivitetin ekonomik. Klasifikimi gjithashtu varet nga të kuptuarit e qartë se cilat aktivitete konsiderohen si “punësim”.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës (të punësuar apo të papunësuar). Raporti i fuqisë punëtore (të punësuarit dhe të papunët) ndaj popullsisë në moshë pune, i shprehur si përqindje është:

$$\textbf{Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore} = \frac{\textit{Të punësuar} + \textit{Të papunë}}{\textit{Popullsia në moshë pune}} \textbf{x100}$$

Shkalla e jo-aktivitetit është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që nuk bënë pjesë në fuqinë punëtore (as të punësuar as të papunë). Kur mblidhen së bashku, shkalla e jo-aktivitetit dhe ajo e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore japin rezultatin 100 për qind.

Raporti i punësimit ndaj popullsisë, i njohur edhe si shkalla e punësimit, është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që është e punësuar.

$$\textbf{Raporti i punësimit ndaj popullsisë} = \frac{Popullsia\ e\ punësuar}{Popullsia\ në\ moshë\ pune} \textbf{ x100}$$

Shkalla e papunësisë është përqindja e fuqisë punëtore, që nuk është e punësuar. Fuqia punëtore përcaktohet si bazë për këtë indikator dhe jo popullsia në moshë pune.

$$\textbf{Shkalla e papunësisë} = \frac{Të\ papunë}{Fuqi\ punëtore} \textbf{ x100}$$

Punonjës të dekurajuar janë personat që nuk kanë punë, të cilët aktualisht janë të gatshëm për punë, por që kanë hequr dorë së kërkuari punë sepse besojnë se nuk mund të gjejnë punë. Kjo kategori e personave të dekurajuar përfshihen në kategorinë e popullsisë joaktive.


Papunësia e të rinjve i referohet papunësisë së personave të moshës 15-24 vjeç.

NEET përbëjnë pjesën e të rinjve (15-24 vjeç), që nuk janë as të punësuar, nuk ndjekin as shkollim dhe as trajnim.

Punësimi i paqëndrueshëm i referohet personave të vetëpunësuar, që nuk kanë të punësuar ose punëtorëve të papaguar familjarë. Këta lloj të punësuarish kanë më pak gjasa të kenë marrëveshje formale pune dhe ka më shumë gjasa që këtyre t'u mungojnë kushtet e përshtatshme për punë.

Diagrami i mëposhtëm, ilustron kriteret, që përdoren për klasifikimin e popullsisë në moshe pune si të punësuar, të papunë, apo joaktive.

Grafi. 1: Klasifikimi i fuqisë punëtore në Anketën e Fuqisë Punëtore të Bashkimit Evropian



Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në të dhënat e tregut të punës në Kosovë në TM4 2020

Mbledhja e të dhënave gjatë Pandemisë COVID-19

Për shkak të Pandemisë COVID-19 që kishte përfshirë edhe Republikën e Kosovës (mesi i muajit Mars 2020), Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për TM1 2020 nuk janë publikuar sipas datës së planifikuar, pasi ASK nuk ka mundur që të vazhdojë grumbullimin e të dhënave në teren pas datës 16 mars 2020 për të kompletuar grumbullimin e të dhënave në kohë për tremujorin e parë 2020. Pas lehtësimit të masave nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës, ASK ndërmori të gjitha hapat e lehtësimit të këtyre masave për vazhdimin e anketave të ASK-së, ndër të tjera edhe vazhdimin e punës në teren për grumbullimin e të dhënave të AFP-së në njësi banesore/ ekonomi familjare.
Vonesat e shfaqura në grumbullimin të dhënave si pasojë e Pandemisë COVID-19 kanë ndikuar që edhe Rezultatet e AFP për TM2, TM3 dhe TM4 të publikohen me vonesë.

Metodologjia dhe mbledhja e të dhënave të AFP-së në TM4 2020.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), publikon të dhënat e punësimit/papunësisë nga Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP), të cilat grumbullohen nga tereni prej anketuesve sipas mostrës së përzgjedhur në njësi banesore/ekonomi familjare. Tremujorët e AFP-së (4 tremujor), janë të ndarë në 13 javë referuese derisa këtë vit tremujori i katërt (TM4) i ka pas 14 javë referuese, si dhe përfshijnë rotacionin e mostrës me anketime dhe ri anketime (për më shumë lidhur me rotacionin e mostrës, shih faqen 2 të publikimit).

Grumbullimi/mbledhja e të dhënave nga tereni:

Për shkak të vonesave të paraqitura në grumbullimin e të dhënave në teren, për TM4 2020 janë pyetur respodentët e njësive banesore/ekonomive familjare për situatën e tyre sipas javëve referuese të TM4 2020.

Për shkak të situatës së krijuar të Pandemisë COVID-19, njësitë banesore/ekonomitë familjare të cilat kanë refuzuar të përgjigjen me kontakt fizik, janë kontaktuar edhe me telefon për marrjen e informatave dhe të gjitha anketat dhe rianketat e parapara për këtë tremujor janë përfunduar.

Tab. A: Javët referuese për tremujorin e katërt

TREMUJORI I KATËRTË – 2020	
Nr.	**Java referuese**
1	28 Shtator – 04 Tetor 2020
2	05 – 11 Tetor 2020
3	12 – 18 Tetor 2020
4	19 – 25 Tetor 2020
5	26 Tetor – 01 Nëntor 2020
6	02 – 08 Nëntor 2020
7	09 – 15 Nëntor 2020
8	16 – 22 Nëntor 2020
9	23 – 29 Nëntor 2020
10	30 Nëntor – 06 Dhjetor 2020
11	07 – 13 Dhjetor 2020
12	14 – 20 Dhjetor 2020
13	21 – 27 Dhjetor 2020
14	28 Dhjetor 2020 – 03 Janar 2021

Tab. B: Qarqet regjistruese, ekonomitë familjare dhe persona të intervistuar në tremujorin e katërt

ANKETA E FUQISË PUNËTORE (AFP)			
TM4 2020	**GJITHSEJ**	**ANKETA**	**RIANKETA**
Qarqe Regjistruese	450	117	333
Ekonomi Familjare	4020	1093	2927
Persona në Ekonomi Familjare	19559	5257	14302
Meshkuj	9746	2640	7106
Femra	9813	2617	7196
Persona grup mosha (0-14)	4049	1048	3001
Meshkuj	2107	575	1532
Femra	1942	473	1469
Persona grup mosha (15 +)	15510	4209	11301
Meshkuj	7639	2065	5574
Femra	7871	2144	5727
Persona grup mosha (15-64)	13369	3629	9740
Meshkuj	6616	1793	4823
Femra	6753	1836	4917
Persona grup mosha (65+)	2141	580	1561
Meshkuj	1023	272	751
Femra	1118	308	810

Treguesit kryesorë

Grafikoni 1 paraqet një përmbledhje të gjendjes së tregut të punës të popullsisë së Kosovës duke u bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore të tremujorit të katërt 2020. Ndër rezultatet kryesore të AFP-së për tremujorin e katërt të vitit 2020, siç paraqitet në grafikonin 1 dhe elaborohet më tej në këtë raport, janë:

• Pothuajse dy të tretat e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-64 vjeç). Pritet që popullsia në moshë pune të rritet shpejt gjatë dekadës së ardhshme pasi Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë.

• Nga popullsia në moshë pune, 58.7 % nuk janë ekonomikisht aktivë, që do të thotë se ata nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara dhe/ose nuk janë të gatshëm të fillojnë punë brenda dy javësh.

• Nga 41.3 % (507,826 persona) e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 27.0 % (136,929 persona) janë të papunë.

• Raporti i punësimit ndaj popullsisë (shkalla e punësimit), 30.2 % (370,897 persona) janë të punësuar.

• 58.7 % e popullsisë në moshë pune, është joaktive.

• Ekzistojnë dallime të mëdha gjinore në tërë tregun e punës.

- Një në pesë (23.8%) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me rreth tri te pestat (59.1 %) e meshkujve në moshë pune.

- Në mesin e personave në fuqinë punëtore, papunësia është më e lartë për femrat se sa për meshkujt (33.5 % krahasuar me 24.3 %).

- Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 15.8 %, krahasuar me 44.8 % për meshkujt.

- Kjo shkallë shumë e ulët e papunësisë te femrat rrjedh nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë.

- Femrat ishin të punësuara kryesisht në sektorët e arsimit, të tregtisë dhe të shëndetësisë (51.5 % e femrave të punësuara). Meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimtarisë, tregtisë dhe prodhimit (duke punësuar 43.8 % të meshkujve të punësuar).

- Papunësia tek të rinjtë është shumë e lartë në Kosovë.

- Në tremujorin e katërt të vitit 2020, të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeçare dhe në fuqinë punëtore, 49.9 % ishin të papunë.
  Papunësia është më e lartë te femrat e reja (53.7 %) se te të rinjtë meshkuj (48.0%).

- Po thuajse një e treta (31.5 %) e personave të moshës 15 deri 24 vjeçare në Kosovë nuk ishin në shkollim, punësim apo trajnim (NEET). Kjo shifër është 31.4 % për femrat e reja krahasuar me 31.5 % për të rinjtë meshkuj.

- Pjesa më e madhe e atyre që janë të punësuar raportojnë të punojnë me orar të plotë.

- 92.0 % e të intervistuarve raportuan se punojnë me orar të plotë në punën e tyre kryesore.

- Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm dallojnë midis dy gjinive, pasi gratë, duke marrë përsipër më shumë rolin e kujdesit brenda familjes, reduktojnë orët në dispozicion për punësim.


- Arsyeja numër një për meshkujt pse nuk punojnë me orar të plotë, ishte mungesa e një pune me orar të plotë.

- 16.0 % e personave të punësuar i përkiste kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm. Kjo do të thotë se ata ose janë të punësuar në biznesin e tyre (punëtorë për llogari vetanake), ose kontribuojnë në një biznes familjar (të paguar ose të papaguar).

- Vetëm 44.6 % e personave të punësuar kishin kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, me 3.5% më i lartë te femrat se sa te meshkujt (47.0 % me 43.5%), ndërkohë që 55.4 % kishin kontratë të përkohshme, me 3.5% më i lartë te meshkujt se sa te femrat (56.5 % me 53.0 %).
  Personat, që kishin kontrata të përkohshme, u pyetën se pse kishin këtë lloj kontrate dhe 79.6 % e të intervistuarve raportuan se nuk kishte kontratë tjetër në dispozicion.

- Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 400 € deri 500 € në muaj.
  Janë vërejtur dallime gjinore me 2.5 % më e lartë te meshkujt se sa te femrat.

Graf. 1: Klasifikimi i tregut të punës për popullsinë e Kosovës, TM4 2020



Tab. 1: Indikatorët kryesorë të tregut të punës

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	59.1	23.8	41.3
Shkalla e joaktivitetit	40.9	76.2	58.7
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	44.8	15.8	30.2
Shkalla e papunësisë	24.3	33.5	27.0
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	48.0	53.7	49.9
Përqindja e të rinjëve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	31.5	31.4	31.5
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	18.4	9.2	16.0

1. Punësimi


1.1: Punësimi sipas gjinisë

Nga e gjithë popullsia në moshë pune, 30.2 % ishin të punësuar. Shkalla e punësimit ishte më e lartë për meshkuj se sa për femra: 44.8 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 15.8 % të femrave po ashtu ne moshë pune.

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM3-2020) në Kosovë, kemi rritje të shkallë së punësimit me 0.1%, ku kemi rënie te meshkujt me 1.4 % derisa te femrat kemi rritje me 1.4 %.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM4-2019) të AFP-së në Kosovë, kemi rënie të shkallës së punësimit me 0.5 %, ku kjo rënie te meshkujt ishte 2.2 % përderisa te femrat kemi rritje për 1.6 %.

Graf. 1.1: Shkalla e punësimit sipas gjinisë



1.2: Punësimi sipas grup moshës dhe nivelit arsimor

Shkalla e punësimit nëpër grup mosha ishte më e larta në mesin e personave të moshës mes 35-44 vjeç (41.5%) dhe më e ultë në mesin e të rinjve (15-24 vjeç) (13.1 %).

Shkalla e punësimit te femrat për grup moshat 25-54 vjeç sillet nga 17.2% deri në 23.3%. Në grup moshën 25-34 vjeç shkalla e punësimit është 19.9% ku kemi rritje me 3.4 % në grup moshën 35-44 vjeç (23.3%) ndërsa kemi rënie me 6.1% krahasuar me grup moshën 45-54 vjeç (17.2%). Ndërsa femra të punësuara në grup moshën e re (15-24 vjeç), ishin vetëm 8.3% derisa në grup moshën e vjetër (55-64 vjeç) ishin 12.8 %.

Tek meshkujt (Tabela 1.1), shkalla e punësimit ishte më e larta për grup moshën 35 deri 44 vjeç (62.1%), pasuar me grup moshën 45 deri 54 vjeç (58.9%) dhe më e ultë për të rinjtë në grup moshën 15 deri 24 vjeç (17.6%).

Tab.1.1: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MIJËRA)			
15-24	30.4	13.4	43.8
25-34	71.4	25.4	96.8
35-44	60.2	25.6	85.7
45-54	64.0	21.1	85.1
55-64	47.1	12.4	59.5
15-64	**273.1**	**97.8**	**370.9**
Raporti punësim ndaj popullsisë (%)			
15-24	17.6	8.3	13.1
25-34	50.0	19.9	35.8
35-44	62.1	23.3	41.5
45-54	58.9	17.2	36.7
55-64	52.8	12.8	31.9
15-64	**44.8**	**15.8**	**30.2**

Tab. 1.2: Punësimi sipas nivelit arsimor

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MIJËRA)			
Pa shkollë	0.6	0.4	0.9
Fillor	41.6	12.4	54.0
Arsim i mesëm profesional	106.6	19.7	126.3
Shkollë e mesme gjimnazi	55.9	20.4	76.4
Terciar	68.4	44.9	113.3
Gjithsej	**273.1**	**97.8**	**370.9**
SHKALLA E PUNËSIMIT (%)			
Pa shkollë	7.1	1.6	3.0
Fillor	28.3	4.6	13.0
Arsim i mesëm profesional	47.0	16.9	36.8
Shkollë e mesme gjimnazi	42.8	17.5	30.9
Terciar	70.2	48.1	59.4
Gjithsej	**44.8**	**15.8**	**30.2**

Tabela 1.2 tregon që sa më i lartë të jetë shkollimi aq më e lartë do të jetë mundësia për të u punësuar (70.2% te meshkujt dhe 48.1% te femrat).

Tab. 1.3: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhënësit (15-64)

Kosovë	Sektori publik, qeveria	Ndërmarrje në pronësi shtetërore	Kompani private	Individuale private
NIVELI MË I LARTË ARSIMOR (%)				
Pa shkollë	0.2	0.0	0.2	0.0
Fillor	4.0	7.8	14.9	39.8
Arsim i mesëm profesional	21.9	36.2	37.5	31.5
Shkollë e mesme gjimnazi	11.3	10.9	24.4	24.2
Terciar	62.6	45.1	23.0	4.5
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**

Tabela 1.3 tregon që kërkesat për vende pune janë më të larta për pozita qeveritare, ku mbi gjysma e të gjithë të punësuarve (62.6%) e kanë të përfunduar arsimin e lartë.

1.3: Statusi i punësimit

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, 74.6% e personave të punësuar ishin punonjës, 9.4% ishin të vetë-punësuar dhe kishin punonjës të tjerë, 11.9% ishin të vetë-punësuar pa punonjës të tjerë dhe 4.0% ishin punëtorë familjarë (Tabela 1.4). Shumica e femrave të punësuara kishin statusin e punonjësit (85.6% krahasuar me 70.7% për meshkujt).

Tab. 1.4: Statusi i punësimit sipas gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Statusi i Punësimit (%)			
Punonjës	70.7	85.6	74.6
I vetë-punësuar me punonjës	11.0	5.2	9.4
I vetë-punësuar pa punonjës	14.6	4.4	11.9
Punëtor familjar i papaguar	3.8	4.8	4.0
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

1.4: Punësimi i paqëndrueshëm

Përveç shkallës së ulët të punësimit në Kosovë, 16.0 % e personave të punësuar punonin në vende pune të paqëndrueshme. Punëtorët në punë të paqëndrueshme janë ose persona të vetëpunësuar pa punonjës, ose ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar. Këto dy grupe punëtorësh kanë gjasat më të ulta të kenë një marrëveshje formale pune në krahasim me punëtorët me pagesë dhe rrogë.

Meshkujt kanë më shumë gjasa të mbajnë punë të tilla të paqëndrueshme (18.4 % e meshkujve të punësuar krahasuar me 9.2% të femrave të punësuara). Shprehur në numra absolutë, 50,215 persona nga 370,897 të punësuar i përkasin kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm (Tabela 1.5). Të punësuarit në fusha profesionale kanë më pak gjasa të jenë të punësuar në punë të paqëndrueshme (Tabela 1.6), si dhe personat me nivel të lartë arsimimi (Tabela 1.7).

Tab. 1.5: Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë

Kosovë	
PUNËSIM I PAQËNDRUESHËM (NË MIJËRA)	
Meshkuj	50.2
Femra	9.0
Të gjithë	**59.2**
PËRQINDJA E PUNËSIMIT TË PAQËNDRUESHËM NË PUNËSIMIN E PËRGJITHSHËM (%)	
Meshkuj	18.4
Femra	9.2
Të gjithë	**16.0**

Tab. 1.6: Punësimi i paqëndrueshëm sipas profesionit dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
TË VETËPUNËSUAR PA PUNONJËS TË TJERË (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	7.0	4.9	6.8
Profesionistë	6.2	5.7	6.2
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	3.2	4.3	3.3
Nëpunës	0.0	0.0	0.0
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	22.8	43.7	24.8
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	12.3	16.7	12.7
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	16.5	21.7	17.0
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	12.9	0.0	11.7
Profesione elementare	19.0	3.1	17.4
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**
PUNËTORË FAMILJARË TË PAPAGUAR (%)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	7.5	4.9	6.7
Profesionistë	0.0	2.1	0.6
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	9.1	0.0	6.2
Nëpunës	0.0	0.0	0.0
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	16.9	12.4	15.4
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	17.0	50.6	27.5
Punëtorë zejtarie dhe të ngjajshëm me ta	14.0	4.7	11.1
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	7.0	0.0	4.8
Profesione elementare	28.6	25.4	27.6
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

Tab. 1.7: Punësimi i paqëndrueshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
TË VETËPUNËSUAR PA PUNONJËS TË TJERË (%)			
Pa shkollë	0.9	0.0	0.8
Fillor	24.1	38.8	25.5
Arsim i mesëm profesional	43.4	25.7	41.7
Shkollë e mesme gjimnazi	19.3	24.0	19.8
Terciar	12.2	11.6	12.2
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100**
PUNËTORË FAMILJARË TË PAPAGUAR (%)			
Pa shkollë	0.0	1.7	0.5
Fillor	28.6	58.0	37.8
Arsim i mesëm profesional	37.4	13.5	29.9
Shkollë e mesme gjimnazi	29.3	24.5	27.8
Terciar	4.6	2.3	3.9
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

1.5: Llojet e kontratave

Për sa i përket llojit të kontratës, që kishin të punësuarit e intervistuar, shumica (85.6%) kishin një kontratë individuale, ndërsa 8.9% punonin pa kontratë, 3.3% kontratë kolektive me punëdhënësin dhe 0.3% kanë deklaruar se kanë kontratë grupi. Për të rinjtë e moshës (15 deri 24 vjeç), përqindja e atyre që punonin pa kontratë ishte 14.1 %.

Nga personat, që kishin kontratë pune, vetëm 44.6 % kishin një kontratë të përhershme për punën e tyre kryesore (43.5% te meshkujt krahasuar me 47.0% te femrat), ndërsa 55.4 % kishin kontrata të përkohshme (56.5% te meshkujt krahasuar me 53.0% te femrat). Personat, që kishin kontrata të përkohshme, u pyetën se pse ata kishin këtë lloj kontrate dhe 79.6% e të intervistuarve raportuan se nuk kishte asnjë lloj tjetër kontrate në dispozicion.

Kur u pyetën nëse kishin të drejtë, në punën e tyre kryesore, të përfitimit nga një skeme e sigurimeve sociale në punë, të dhënat nga anketa treguan se 9.0 % e punonjësve e kishin këtë të drejtë.

1.6: Punësimi sipas aktiviteteve

Tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimi punësonin më shumë se gjysmën e personave të punësuar në tremujorin e katërt të vitit 2020 (tabelat 1.8 dhe 1.9). Tregtia punësonte 15.3%, duke vazhduar me prodhimin me 13.0%, ndërtimtarinë me 11.1% dhe arsimin me 9.9 %, të personave të punësuar në Kosovë.

Arsimi, tregtia dhe kujdesi shëndetësor ishin tre punëdhënësit kryesorë për femrat (duke punësuar 51.5% të femrave të punësuara). Tregtia, ndërtimtaria dhe prodhimi janë sektorët më të zakonshëm të punësimit për meshkujt (duke punësuar 43.8 % të meshkujve të punësuar).

Tab. 1.8: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në mijëra)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	15.1	4.5	19.7
Minierat dhe xehroret	3.6	0.4	4.0
Prodhimi	40.6	8.1	48.7
Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	9.7	0.7	10.5
Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	3.7	0.3	4.0
Ndërtimtari	41.0	0.7	41.7
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash	39.6	17.8	57.4
Transport dhe depozitim	12.7	0.8	13.5
Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	20.1	4.4	24.4
Informim dhe komunikim	10.1	2.7	12.8
Aktivitete financiare dhe sigurimesh	5.1	1.9	7.0
Aktivitete me prona të paluajtshme	0.4	0.0	0.4
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	8.0	4.4	12.4
Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	10.1	5.3	15.4
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	20.4	7.1	27.4
Arsimi	17.3	19.9	37.2
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	7.9	12.9	20.8
Arti, zbavitja dhe rekreacioni	2.8	1.4	4.2
Aktivitete të shërbimeve të tjera	5.8	4.0	9.8
Aktivitete të punësimit shtëpiak	1.3	0.9	2.2
Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	1.3	0.2	1.5
Gjithsej	**276.6**	**98.4**	**374.9**

Tab. 1.9: Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (në %)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	5.5	4.6	5.2
Minierat dhe xehroret	1.3	0.4	1.1
Prodhimi	14.7	8.2	13.0
Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	3.5	0.7	2.8
Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	1.3	0.3	1.1
Ndërtimtari	14.8	0.7	11.1
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash	14.3	18.1	15.3
Transport dhe depozitim	4.6	0.8	3.6
Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	7.3	4.4	6.5
Informim dhe komunikim	3.7	2.7	3.4
Aktivitete financiare dhe sigurimesh	1.9	1.9	1.9
Aktivitete me prona të paluajtshme	0.1	0.0	0.1
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2.9	4.4	3.3
Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3.7	5.4	4.1
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	7.4	7.2	7.3
Arsimi	6.2	20.2	9.9
Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	2.8	13.1	5.5
Arti, zbavitja dhe rekreacioni	1.0	1.4	1.1
Aktivitete të shërbimeve të tjera	2.1	4.1	2.6
Aktivitete të punësimit shtëpiak	0.5	0.9	0.6
Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.5	0.2	0.4
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

1.7: Punësimi sipas profesioneve

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, shumica e të punësuarve kishin pozita pune në: shërbime dhe shitje, në profesione elementare, si profesionistë, dhe si punëtorë zejtarie (Tabela 1.10).

Pothuajse gjysma e femrave të punësuara ishin: profesioniste, teknike dhe profesione që lidhen me to (39.5%), 21.4 % në shërbime dhe shitje dhe 11.8% ishin në profesione elementare. Meshkujt ishin më të shpërndarë nëpër sektorë, por shumica ishin të punësuar si: punonjës në shërbime dhe shitje (23.4%), 13.0% si punëtor zejtare dhe te ngjashëm me të, profesione elementare (20.3%) ndërsa 10.5% ishin profesionistë (Tabela 1.10).

Tab. 1.10: Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë (në %)

Kosovë (mosha 15 e më shumë)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI SIPAS PROFESIONEVE (NË MIJËRA)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	27.9	7.4	35.3
Profesionistë	29.2	32.0	61.1
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	18.7	6.9	25.6
Nëpunës	15.6	9.8	25.4
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	64.8	21.0	85.8
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	8.2	3.5	11.7
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	35.8	5.2	41.0
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	20.2	0.9	21.1
Profesione elementare	56.2	11.7	67.9
Gjithsej	**276.6**	**98.4**	**374.9**
PUNËSIMI SIPAS PROFESIONEVE (NË %)			
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	10.1	7.5	9.4
Profesionistë	10.5	32.5	16.3
Teknikë dhe profesione të lidhura	6.8	7.0	6.8
Nëpunës	5.6	9.9	6.8
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	23.4	21.4	22.9
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	3.0	3.6	3.1
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	13.0	5.2	10.9
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montatorë	7.3	0.9	5.6
Profesione elementare	20.3	11.8	18.1
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

1.8: Modelet e punës

Vetëm 1.1 % e popullsisë së punësuar kanë raportuar se kishin një punë të dytë gjatë javës referente (1.1% e meshkujve krahasuar me 1.2% e femrave).

Në punën e tyre kryesore, 92.0 % e të intervistuarve raportuan se punojnë me orar të plotë dhe 8.0% me orar të pjesshëm/orar të shkurtuar. Nuk janë vërejtur dallime gjinore, që femrat të punojnë me orar të pjesshëm (8.0% te meshkujt krahasuar me 7.9%).

Për ata që bëjnë punë me orar të pjesshëm, arsyet dallonin midis dy gjinive, gratë marrin një rol më të madh kujdesi brenda familjes duke reduktuar kështu orët në dispozicion për të punuar (Tabela 1.11). Arsyeja numër një për meshkujt pse nuk punojnë me orar të plotë, ishte mungesa e disponueshmërisë së punës me orar të plotë.

Tab. 1.11: Arsyet e të punuarit me orar të pjesshëm sipas gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Kujdesi për fëmijët apo të rriturit me aftësi të kufizuar	0.3	1.1	0.5
Invaliditet ose sëmundje	0.8	0.0	0.6
Arsye të tjera personale ose familjare	5.9	17.0	8.6
Vazhdon shkollën ose trajnimin	3.8	6.4	4.4
Nuk ka mundsë të gjejë punë me orar të plotë	65.9	43.2	60.3
Nuk dëshiron një punë me orar të plotë	0.9	4.8	1.9
Arsye tjetër	22.4	27.4	23.6
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

Brenda një jave, 75.2 % e të punësuarve kanë punuar midis 40-48 orë në javë, 6.3 % e të punësuarve kanë punuar midis 49-59 orë në javë, 3.5% e të punësuarve kanë punuar 60 ose më shumë orë në javë. Brenda një jave, 15.0 % e të punësuarve kanë punuar më pak se 40 orë.

Meshkujt priren të punojnë me orare më të gjata se femrat, 12.4 % e meshkujve punojnë më shumë se 48 orë në javë krahasuar me 2.4 % të femrave (Tabela 1.12). Një pjesë më e madhe e femrave të punësuara (16.6%) ka punuar më pak se 40 orë në krahasim me 14.4 % e meshkujve.

Tab. 1.12: Punësimi sipas orëve të punës në javë dhe sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI SIPAS NUMRIT TË ORËVE (NË MIJËRA)			
Më pak se 25	24.4	10.4	34.8
25-34	13.3	4.5	17.9
35-39	1.6	1.3	2.9
40-48	199.7	79.2	278.9
49-59	21.9	1.5	23.4
60 e më shumë	12.1	0.9	13.1
Gjithsej	**273.1**	**97.8**	**370.9**
PUNËSIMI SIPAS NUMRIT TË ORËVE (NË %)			
Më pak se 25	8.9	10.7	9.4
25-34	4.9	4.6	4.8
35-39	0.6	1.3	0.8
40-48	73.1	81.0	75.2
49-59	8.0	1.5	6.3
60 e më shumë	4.4	0.9	3.5
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

Të intervistuarit, që punojnë në sektorin publik, kanë raportuar orar më të shkurtër të punës se ata në sektorin privat (Tabela 1.13). Meshkujt dhe femrat, që punojnë në kompani private, kanë punuar me orare më të gjata krahasuar me të gjitha llojet e punësimit.

Tab. 1.13: Numri mesatar i orëve të punuara në jave sipas llojit të punëdhënësit dhe gjinisë

Kosovë	Sektori publik, qeveria	Ndërmarrje në pronësi shtetërore	Kompani private	Individuale private
Meshkuj	38.7	39.3	44.3	39.2
Femra	37.9	36.8	41.9	28.9
Gjithsej	**38.4**	**38.7**	**43.6**	**37.1**

Gjasat janë më të vogla që femrat të punojnë me ndërrime, gjatë ndërrimeve të natës, mbrëmjeve dhe fundjavave por pak më të mëdha që të punojnë nga shtëpia (Tabela 1.14).


Tab. 1.14: Modelet e punësimit sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
NËSE PUNON ME NDËRRIME			
Punon me ndërrime	26.4	27.6	26.8
Nuk punon me ndërrime	73.6	72.4	73.2
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**
NËSE PUNON MBRËMJEVE			
Zakonisht	8.5	6.2	7.9
Ndonjëherë	32.8	26.7	31.2
Kurrë	58.7	67.1	60.9
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**
NËSE PUNON NATËN			
Zakonisht	3.5	1.1	2.9
Ndonjëherë	17.8	10.7	15.9
Kurrë	78.8	88.1	81.2
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**
NËSE PUNON TË SHTUNAVE			
Zakonisht	43.9	25.8	39.2
Ndonjëherë	31.6	26.0	30.1
Kurrë	24.5	48.1	30.6
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**
NËSE PUNON TË DIELAVE			
Zakonisht	6.8	5.2	6.4
Ndonjëherë	34.3	22.4	31.2
Kurrë	58.9	72.4	62.4
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**
NËSE PUNON NË SHTËPI			
Zakonisht	3.5	8.0	4.7
Ndonjëherë	17.9	17.8	17.9
Kurrë	78.6	74.2	77.4
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

1.9: Paga mujore neto

Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 400 € deri 500 € në muaj. Janë vërejtur dallime gjinore me 2.5 % më e lartë te meshkujt se sa te femrat.

Graf. 1.2: Paga mujore neto për punonjësit sipas gjinisë



2. Papunësia


2.1: Papunësia sipas gjinisë

Sipas tremujorit të katërt të AFP-së 2020 në Kosovë ka pasur 136,929 persona të moshës 15-64 vjeç, që ishin të papunë, 87,667 nga të cilët ishin meshkuj dhe 49,262 femra (Tabela 2.1). Shkalla e papunësisë ishte 27.0 %, më e lartë ishte tek femrat me 33.5% se sa te meshkuj, 24.3 % (Graf. 2.1).

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM3-2020) në Kosovë, kemi rritje të shkallës së papunësisë me 2.4%, ku kjo rritje te meshkujt ishte me 2.8%, përderisa te femrat kemi rritje me 0.4%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM4-2019) të AFP-së në Kosovë, kemi rritje të shkallës së papunësisë me 1.1%, ku kemi rritje te meshkujt me 2.3% përderisa te femrat kemi rënie të shkallës së papunësisë me 3.1%.

Graf. 2.1: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë



Tab. 2.1: Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
15-64	87.7	49.3	136.9
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
15-64	**24.3**	**33.5**	**27.0**

2.2: Papunësia sipas grup moshës dhe nivelit arsimor

Popullsia e re në Kosovë, ka një shifër mjaft të lartë papunësie me 49.9 % (Tabela 2.2). Ndërsa sa i përket grup moshave tjera, shkalla më e ulët e papunësisë është hasur në mesin e personave të moshës 55-64 vjeç (9.6%).

Tab. 2.2. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
15-24	28.0	15.6	43.6
25-34	27.8	18.3	46.0
35-44	12.6	8.9	21.5
45-54	13.7	5.7	19.4
55-64	5.5	0.8	6.3
15-64	**87.7**	**49.3**	**136.9**
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
15-24	48.0	53.7	49.9
25-34	28.0	41.8	32.2
35-44	17.4	25.8	20.1
45-54	17.6	21.4	18.6
55-64	10.5	6.1	9.6
15-64	**24.3**	**33.5**	**27.0**

Shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (63.6% e këtij grupi ishin të papunë) dhe më e ultë për personat që kishin përfunduar shkollimin terciar (21.5%).

Tabela 2.3. Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)			
Pa shkollë	1.5	0.1	1.6
Fillor	18.5	7.5	26.0
Arsim profesional i mesëm	34.1	11.1	45.1
Shkollë e mesme gjimnazi	20.5	12.7	33.2
Terciar	13.1	17.9	31.1
Totali	**87.7**	**49.3**	**136.9**
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)			
Pa shkollë	72.9	20.2	63.6
Fillor	30.8	37.6	32.5
Arsim profesional i mesëm	24.2	36.0	26.3
Shkollë e mesme gjimnazi	26.8	38.3	30.3
Terciar	16.1	28.5	21.5
Totali	**24.3**	**33.5**	**27.0**

Shkollimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës, në veçanti për meshkujt pasi 72.9 % e meshkujve të pashkolluar ishin të papunë, në krahasim me 16.1% të atyre që kishin përfunduar arsimin terciar.

2.3: Papunësia tek të rinjtë

Bazuar në tremujorin e katërt të AFP-në e vitit 2020, 31.8% e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshës 15-24 vjeç) me 0.4 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave.

Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (49.9%) dhe shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (53.7 %) krahasuar me meshkujt (48.0%).

Tab. 2.4: Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme dhe shkalla e papunësisë tek të rinjtë sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Përqindja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme (%)	32.0	31.6	31.8
Përqindja e të rinjve si të papunë në popullsinë e re (%)	48.0	53.7	49.9

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë në krahasim me të rriturit, me 0.5 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave. (Tabela 2.5).

Tab. 2.5: Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj të rriturve, sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e papunësisë së të rinjve ndaj papunësisë së të rriturve	2.4	1.9	2.2

2.4: Kohëzgjatja e papunësisë


Të intervistuarit e papunë janë pyetur për sa kohë janë të papunë. Një numër i madh (72.2%) i te papunëve raportuan se janë të papunë për më gjatë se 12 muaj. Janë vërejtur dallime gjinore me 2.4 pikë diference midis meshkujve dhe femrave (71.3% e meshkujve dhe 73.7% e femrave).
(Tabela 2.6) tregon se gjasat për të qenë i/e papunë për më shumë se një vit rriten me moshën.

Tabela 2.6: Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%)

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
15-19	40.9	67.7	51.8
20-24	59.5	66.4	61.9
25-29	81.7	72.6	78.2
30-34	70.7	78.6	73.9
35-39	78.3	78.8	78.5
40-44	80.9	80.5	80.7
45-49	80.5	80.0	80.3
50-54	80.6	73.2	78.7
55-59	71.3	81.9	73.1
60-64	88.1	100.0	88.5
Gjithsej	**71.3**	**73.7**	**72.2**

Grafikoni 2.2. tregon se grup mosha 25-29 edhe pse grup moshë e re, te femrat papunësia për më shumë se një vit arrin 72.6% krahasuar me 81.7% te meshkujt.

Graf. 2.2. Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit sipas grup moshës dhe gjinisë (%)




3. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, nga popullsia e përgjithshme e përllogaritur prej 1,795,666, popullsia e përgjithshme në moshë pune (15 deri 64 vjeç) ishte 1,228,218 persona. 41.3% e personave në moshë pune merrnin pjesë në fuqinë punëtore (ekonomikisht aktivë). Kjo do të thotë se ata ishin ose të punësuar ose të papunë (por aktivë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për punë). Pjesa tjetër prej 58.7% ishin ekonomikisht joaktivë (Grafi. 4.1). Personat ekonomikisht joaktivë përfshijnë studentët, amviset, punonjësit e dekurajuar dhe persona të tjerë, të cilët nuk ishin aktivë në kërkim të një pune dhe kjo kategori shqyrtohet më hollësisht në kapitullin e ardhshëm.

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM3-2020) në Kosovë, kemi rritje te shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore me 1.3%, ku kjo rritje te meshkujt ishte me 0.2% përderisa te femrat kjo rritje ishte me 2.3%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM4-2019) të AFP-së në Kosovë, kemi rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore me 0.1 %, ku kemi rënie te meshkujt me 1.1%, përderisa te femrat kemi rritje me 1.4 %.

Graf. 3.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë



Në grafikun 3.1 është e qartë se pjesëmarrja ne fuqinë punëtore në mesin e femrave ishte shumë më e ulët se në mesin e meshkujve: 23.8 % e femrave ishin aktive në krahasim me 59.1 % e meshkujve.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte më e larta në mesin e personave të moshës 35-39 vjeç (53.3 %) dhe më e ultë në mesin e personave të moshës 15 deri 19 vjeç me 9.9 % (Tabela 3.1). Shkalla e ulët e pjesëmarrjes së të rinjve nuk është për t'u habitur sepse shumica e këtij grupi ndjekin shkollën.

Tek meshkujt, moshat 35-39 vjeç kishin shkallë më të lartë pjesëmarrjeje (75.4 %), ndërsa për femrat shkalla më e lartë ishte në grup moshën, 25-29 vjeç (38.0 %) (Tabela 3.1).

Tab. 3.1: Fuqia punëtore dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas gjinisë dhe grup moshës

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia Punëtore (në mijëra)			
15-19	10.6	5.3	16.0
20-24	47.7	23.7	71.4
25-29	48.7	27.2	76.0
30-34	50.5	16.4	66.9
35-39	36.2	17.3	53.5
40-44	36.7	17.1	53.8
45-49	41.7	14.6	56.4
50-54	36.0	12.2	48.2
55-59	32.4	7.3	39.7
60-64	20.2	5.9	26.1
Totali 15 - 64	**360.8**	**147.1**	**507.8**
Shkalla e Pjesëmarrjes në Fuqinë Punëtore (%)			
15-19	13.4	6.4	9.9
20-24	51.1	30.4	41.7
25-29	66.6	38.0	52.4
30-34	72.5	29.2	53.1
35-39	75.4	33.0	53.3
40-44	74.9	30.0	50.8
45-49	78.7	23.4	48.8
50-54	64.6	20.2	41.5
55-59	66.5	13.4	38.6
60-64	50.0	13.8	31.3
Totali 15 - 64	**59.1**	**23.8**	**41.3**

4. Personat joaktivë


Vëmendje e veçantë i është kushtuar përshkrimit dhe vlerësimit të popullsisë së punësuar dhe asaj të papunë, që së bashku përbëjnë Fuqinë Punëtore (ose personat ekonomikisht aktivë). Megjithatë, kategoria "joaktivë" është po aq e rëndësishme. Ndryshimet në shkallën e aktivitetit janë pjesë e rëndësishme e ndikimit të ofertës së punës në rritjen potenciale ekonomike. Kjo për shkak të numrit të madh të punëtorëve potencialë në mesin e personave aktualisht joaktivë.

Krahasuar me tremujorin paraprak të AFP-së (TM3-2020) në Kosovë, kemi rënie te shkalla e jo aktivitetit me 1.3%, ku kjo rënie te meshkujt ishte 0.2% përderisa te femrat kjo rënie ishte 2.3%.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM4-2019) të AFP-së në Kosovë, kemi rritje të shkallës së jo aktivitetit me 0.1 %, ku kjo rritje te meshkujt ishte me 1.1 % përderisa te femrat kemi rënie me 1.4 %.

Në grafikun 4.1 është e qartë se pjesëmarrja më e madhe është në mesin e femrave se në mesin e meshkujve: 76.2% e femrave ishin jo aktive në krahasim me 40.9% e meshkujve.

Graf 4.1: Shkalla e pjesëmarrjes jo aktive sipas gjinisë



4.1: Të rinjtë joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)

Të rinjtë e këtij grupi (NEET) përfshijnë të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën, as nuk trajnohen, d.m.th. janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës dhe nuk marrin pjesë as në sistemin arsimor. Përqindjet e larta të këtij grupi në popullsinë e të rinjve rrisin shqetësimet në lidhje me punësimin e të rinjve në të ardhmen pasi tregon shkëputje nga tregu i punës. Përveç kësaj, një numër i madh i të rinjve të pa angazhuar në vendet me papunësi të lartë të të rinjve, siç është Kosova, mund të shkaktojë uljen e fitimeve për shkak të rritjes së konkurrencës, si dhe ka mundësi t'i kontribuojë problemeve sociale.

Në tremujorin e katërt të vitit 2020, 104,876 të rinj (të moshës 15 deri 24) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim dhe përbënin 31.5 % të popullsisë së re. Pjesa e femrave NEET është 31.4% krahasuar me 31.5% të meshkujve (Tabela 4.2).

Tab. 4.1: Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollë ose trajnim (NEET) sipas gjinisë

Kosovë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Të rinj NEET (në mijëra)	54.3	50.5	104.9
Përqindja e të rinjve NEET në popullsinë e re (%)	31.5	31.4	31.5

5. Shkallët e varësisë demografike dhe ekonomike

Në Tabelën 5.1 janë paraqitur tri shkallë të varësisë ekonomike (me të dhënat e paraqitura si përqindja e të varurve për 100 nga popullsia në moshë pune):

- Shkalla e varësisë së të rinjve (të intervistuarit e moshës nën 15/të intervistuarit e moshës 15-64)
- Shkalla e varësisë se të moshuarve (të intervistuarit e moshës 65+/ të intervistuarit e moshës 15-64)
- Shkalla e varësisë moshore (të intervistuarit më të rinj se 15 ose më të vjetër se 64/ të intervistuarit e moshës 15-64).

Tab. 5.1: Shkallët e varësisë demografike

Kosovë	Shkalla e varësisë së të rinjve	Shkalla e varësisë së të moshuarve	Shkalla e varësisë moshore
TM4 - 2020	30%	16%	46%

Një shkallë tjetër e përdorur shpesh, në veçanti në publikimet e Eurostat-it, është shkalla e varësisë efektive ekonomike e të moshuarve. Ky është një indikator i rëndësishëm për vlerësimin e ndikimit potencial të moshës së shtyrë në shpenzimet sociale, që lidhen me punësimin (pensionet etj.). Ky indikator kalkulohet si raport midis popullsisë së moshës 65+ (të gjithë të klasifikuar si joaktivë) dhe punësimit të përgjithshëm. Për këtë raport Eurostat-i ka vendosur gamën e moshës për të punësuarit nga 20 deri në 64 vjeç. Sipas projeksioneve, ky indikator do të rritet në 68 % në vitin 2060 në BE28. Në Kosovë ky raport ishte 46 % për tremujorin e katërt të vitit 2020.

Tab. 5.2: Shkallët e varësisë ekonomike

Kosovë	Shkalla e varësisë efektive ekonomike e të moshuarve	Shkalla totale e varësisë ekonomike
TM4 - 2020	54%	250%

Shkalla totale e varësisë ekonomike kalkulohet si raport midis popullsisë së përgjithshme joaktive (15+) dhe punësimit (20-64 vjeç). Ai mat numrin mesatar të personave të moshës 15 vjeç e më shumë, që "përkrah" secili i punësuar. Ky raport ishte 250% në tremujorin e katërtë të vitit 2020.
Sipas projeksioneve deri në vitin 2023 ky raport do të vazhdojë të rritet në BE, në 122.2% në vitin 2023 dhe 141.6 % në vitin 2060.

6. Saktësia e të dhënave

Besueshmëria dhe saktësia e rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) është e varur nga mungesa e përgjigjeve gjatë procesit të intervistimit, gabimeve gjatë përpunimit të të dhënave dhe gjatë dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës.

Efekti i rastësishëm për shkak të mostrimit do të thotë se rezultatet e llogaritura nga mostra të ndryshme devijojnë disi nga njëri-tjetri. Shifrat e të punësuarve dhe të papunëve, që janë nxjerrë të bazuara në një mostër më madhe dhe më reprezentative janë më të sakta sesa ato që bazohen në mostra më të vogla.

Pasaktësia për shkak të dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës vlerësohet me gabimin standard të vlerësimit. Madhësia e gabimit standard ndikohet nga madhësia e mostrës dhe varianca e variablave që janë objekt studimi. Gabimi standard mund të përdoret për të llogaritur intervalin e besimit, brenda të cilit vlera e popullsisë qëndron me një probabilitet të caktuar. Vlerësimi në nivel vendi për shkallën e papunësisë në bazë AFP-së për tremujorin e katërt të vitit 2020 është 27.0% dhe gabimi i tij standard është 1.1% ndërsa intervali i besueshmërisë për shkallën e papunësisë është (24.9%; 29.0%).

Tab. 6: Saktësia e vlerësimeve në bazë të AFP-së për tremujorin e katërtë të vitit 2020 në nivel vendi

Kosovë TM4 2020	Vlerësimet tremujore (%)	Gabimi standard	Intervali i besueshmërisë 95%		Koeficienti i Variacionit (%)
			I ulët	I sipërm	
Shkalla e punësimit	30.2	0.6	29.0	31.4	2.0
Shkalla e papunësisë	27.0	1.1	24.9	29.0	3.9
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	41.3	0.7	39.9	42.8	1.7

Saktësia e vlerësimeve paraqitet në bazë të gabimit të tyre standard. Gabimi standard (rrënja katrore e variancës së mostrës) përshkruan se sa saktë vlera e parametrit të vlerësuar nga mostra është e përqendruar rreth parametrit të popullsisë.

Shifrat kryesore të besueshmërisë që rrjedhin nga gabimi standard janë intervalet e besueshmërisë dhe gabimi standard relativ (koeficienti i variacionit). Intervali i besimit përshkruan gjerësinë në të cilin vlera reale e parametrit është në raport me vlerësimin e llogaritur nga mostra. Kur llogaritni intervalin e besimit, niveli i dëshiruar i rrezikut është i fiksuar. Niveli i rrezikut prej 5 për qind i aplikuar në anketën e fuqisë punëtore nënkupton që nëse mostrat do të tërhiqen përsëri, në 95 raste nga njëqind, vlera reale e parametrit do të ishte brenda intervalit të besimit dhe në 5 raste nga njëqind do të të jetë jashtë intervalit të besimit.

7. Indikatorët kryesor në shtetet e Evropës Juglindore

Në tabelat: 7.1; 7.2; 7.3 dhe 7.4 janë paraqitur indikatorët kryesor në shtetet e Evropës Juglindore.

Tab. 7.1: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore

Shtetet e Evropës Juglindore (grup mosha 15-64)	*Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore*											
	TM1 2020			TM2 2020			TM3 2020			TM4 2020		
	Total	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*
Kosova	**38.8**	57.1	20.3	**33.2**	48.8	17.6	**40.0**	58.9	21.5	**41.3**	59.1	23.8
Shqipëria	**69.6**	77.6	61.9	**68.1**	75.7	60.7	**69.8**	77.9	61.8	**68.7**	77.2	60.5
Maqedonia Veriore	**66.5**	78.0	54.7	**65.6**	76.2	54.7	**65.0**	75.7	53.9	**65.0**	76.8	52.8
Mali i Zi	**65.2**	70.8	59.6	**60.8**	66.8	54.7	**61.2**	69.3	53.2	**58.9**	66.3	51.5
Serbia	**67.6**	73.4	61.9	**65.2**	72.0	58.4	**68.7**	76.1	61.3	**69.3**	77.0	61.7
Bosnia dhe Herxegovina	**57.6**	70.3	44.9	**57.6**	70.0	45.2	**58.7**	70.1	47.3	**59.0**	71.1	46.8

Tab. 7.2: Shkalla e punësimit

Shtetet e Evropës Juglindore (grup mosha 15-64)	*Shkalla e punësimit*											
	TM1 2020			TM2 2020			TM3 2020			TM4 2020		
	Total	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*
Kosova	**29.1**	44.0	14.1	**24.1**	36.2	12.1	**30.1**	46.2	14.4	**30.2**	44.8	15.8
Shqipëria	**61.4**	68.7	54.2	**59.6**	66.2	53.2	**61.3**	68.7	54.2	**60.2**	67.8	52.9
Maqedonia Veriore	**55.6**	64.9	46.1	**54.5**	63.3	45.4	**54.1**	62.7	42.2	**54.4**	63.9	44.6
Mali i Zi	**54.4**	59.6	49.1	**51.2**	56.4	46.0	**49.3**	55.9	42.6	**46.2**	52.6	39.9
Serbia	**60.7**	66.1	55.3	**60.2**	66.6	53.7	**62.2**	69.1	55.2	**62.1**	69.1	55.0
Bosnia dhe Herxegovina	**47.8**	59.6	35.9	**48.2**	60.1	36.3	**50.2**	60.8	39.5	**49.0**	60.5	37.5

Tab. 7.3: Shkalla e papunësisë

Shtetet e Evropës Juglindore (grup mosha 15-64)	*Shkalla e papunësisë*											
	TM1 2020			TM2 2020			TM3 2020			TM4 2020		
	Total	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*
Kosova	**25.0**	23.0	30.6	**27.2**	25.7	31.4	**24.6**	21.5	33.1	**27.0**	24.3	33.5
Shqipëria	**11.9**	11.5	12.4	**12.5**	12.6	12.4	**12.1**	11.9	12.3	**12.3**	12.2	12.5
Maqedonia Veriore	**16.4**	16.8	15.8	**16.9**	17.0	16.9	**16.7**	17.2	16.0	**16.3**	16.8	15.7
Mali i Zi	**16.6**	15.8	17.6	**15.7**	15.6	15.9	**19.6**	19.3	19.9	**21.5**	20.7	22.4
Serbia	**10.2**	9.9	10.6	**7.7**	7.4	8.0	**9.5**	9.2	9.9	**10.5**	10.1	10.8
Bosnia dhe Herxegovina	**17.0**	15.1	19.9	**16.3**	14.2	19.6	**14.5**	13.2	16.5	**16.9**	15.0	19.9

Tab. 7.4: Shkalla e jo aktivitetit

Shtetet e Evropës Juglindore (grup mosha 15-64)	*Shkalla e jo aktivitetit*											
	TM1 2020			TM2 2020			TM3 2020			TM4 2020		
	Total	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*	*Total*	*Meshkuj*	*Femra*
Kosova	**61.2**	42.9	79.7	**66.8**	51.2	82.4	**60.0**	41.1	78.5	**58.7**	40.9	76.2
Shqipëria	**30.4**	22.4	38.1	**31.9**	24.3	39.3	**30.2**	22.1	38.2	**31.3**	22.8	39.5
Maqedonia Veriore	**33.5**	22.0	45.3	**34.4**	23.8	45.3	**35.0**	24.3	46.1	**35.0**	23.2	47.2
Mali i Zi	**34.8**	29.2	40.4	**39.2**	33.2	45.3	**38.8**	30.7	46.8	**41.1**	33.7	48.5
Serbia	**32.4**	26.6	38.1	**34.8**	28.0	41.6	**31.3**	23.9	38.7	**30.7**	23.0	38.3
Bosnia dhe Herxegovina	**42.4**	29.7	55.1	**42.4**	30.0	54.8	**41.3**	29.9	52.7	**41.0**	28.9	53.2

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili kia hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës *ka këtë strukture organizative:* ***Departamentet prodhuese;*** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* ***Departamentet mbështetëse;*** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* ***Ne kuadër të*** **Agjencionit** ***veprojn edhe; Zyrat Rajonale;*** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministritë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistrues terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë qe t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
  Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
  Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:**: +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** http://ask.rks-gov.net